



Kanton Zürich
Sicherheitsdirektion
Migrationsamt

Informacione për qëndrimin tuaj



Grëezi dhe mirë se vini në Zvicër! Në këtë broshurë ju gjeni informacionet më të rëndësishme për të drejtën tuaj të qëndrimit.

Të huajat dhe të huajt duhet të integrohen në Zvicër. Kjo do të thotë që ata merren aktivisht me kushtet e jetesës në Zvicër. Sa më mirë të integroheni ju, aq më herët mund të merrni ju një leje më të mirëfortë. Kantonet dhe komunat ju ndihmojnë në integrimin tuaj dhe ju informojnë për oferta të përshtatshme të integrimit.

Në çdo dhënie ose zgjatje të lejes suaj Zyra e Migrimit e kantonit Cyrih e shqyrton integrimin tuaj. Nëse ju integroheni keq ose nuk integroheni fare, ju mund ta humbisni lejen.



Kriteret e integritit

Integrim do të thotë:



Ju nuk bëheni i dënueshëm/e dënueshme.



Ju i respektoni të drejtat themelore në Zvicër.

Shembuj:

- Ju e respektoni barazinë midis burrit dhe gruas.
- Ju e respektoni lirinë e shprehjes.
- Ju e respektoni lirinë e besimit fetar.



Ju i zbatoni urdhrat e autoriteteve.



Ju i paguani faturat tuaja.




Ju kuptoni dhe flisni gjermanisht. Për të marrë informacione për ofertën e nxitjes së gjuhës në afërsinë tuaj, drejtojuni komunës suaj të banimit. Edhe Fachstelle Integration (zyra e specializuar për çështje të integritit) mund t'ju ndihmojë në këtë (www.integration.zh.ch).



Ju punoni dhe nuk merrni ndihmë sociale.

Si përfitoni ju nga një integrim i mirë? Leja e përhershme qëndrimi (C)



Në rast të integritit të mirë juve mund t'ju jepet leja e përhershme e qëndrimit. Kjo leje nuk është e kufizuar në afat. Vetëm letërnjoftimi juaj duhet të zgjatet çdo pesë vjet. Kusht është që ju të jeni integruar mirë dhe të kuptoni dhe flisni gjermanisht në nivelin e gjuhës A2.



Bashkimi familjar

Edhe për bashkimin familjar me bashkëshortin tuaj të huaj dhe fëmijët tuaj beqarë nën 18 vjeç/e një kusht është integrimi. Bashkimi familjar është i mundshëm:



- nëse ju keni një banesë mjaftueshëm të madhe për familjen;



- nëse ju nuk merrni ndihmë sociale, as përfitime plotësuese;




- bashkëshorti juaj / bashkëshortja juaj flet gjermanisht në nivelin e gjuhës A1;




- afatet e bashkimit familjar janë respektuar.



Çfarë ndodh, nëse ju nuk integroheni?



Nëse ju keni një leje B (leja e qëndrimit) dhe nuk integroheni, ju mund ta humbisni atë dhe duhet të largoheni nga Zvicra.



Ulja e kategorisë

Nëse ju keni një leje C (lejen e përhershme të qëndrimit) dhe nuk integroheni, ju mund ta humbisni atë dhe të merrni akoma vetëm një leje B (leja e qëndrimit). Nëse ju keni një leje B (leja e qëndrimit) dhe nuk integroheni, ju mund ta humbisni atë dhe duhet të largoheni nga Zvicra.



Oferta për integrim

Merruni sa më herët që të jetë e mundur me integrimin tuaj. Ekzistojnë shumë oferta që ju mbështetin gjatë kësaj. Një zgjedhje e ofertave ndihmuese për integrim në kantonin Cyrih gjeni në faqen e internetit të Fachstelle Integration (zyra e specializuar për çështje të integritit) nën (www.integration.zh.ch). Në rast të pyetjeve drejtojeni të ngarkuarve për integrim të komunës suaj të banimit, të cilët mund t'ju këshillojnë në mënyrë kompetente.



Informacione të mëtejshme për të drejtën e të huajve

Informacione të detajuara për të drejtën e të huajve gjeni në udhëzimet e Zyrës së Migritit të kantonit të Cyrihut www.ma.zh.ch.



Kanton Zürich
Sicherheitsdirektion
Migrationsamt

Berninastrasse 45
8090 Zürich
Telefon +41 43 259 88 00
www.ma.zh.ch

